

PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar: ‘Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje’.
2. Audiencia e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audiencia e synuar (p.sh. dhomat e tregëtisë, OJQ-të për të rinjtë, etj.)	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projekt-ligjet	Metodat e konsultimit (e-konsultimi, takimet publike,seminare,sondazhe etj.)	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (email, rrjetet sociale, etj.)
Përfaqësues nga ministritë e linjës, INSTAT, Policia e Shtetit	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Takim konsultues me ekspertët dhe sekretariatin teknik nga Drejtoria e Barazisë Gjinore;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>e-konsultim;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Takim konsultues me ekspertët dhe sekretariatin teknik nga Drejtoria e Barazisë Gjinore;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Institucionet e Pavarura për të Drejtat e Njeriut (Avokati i popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Takim konsultues me ekspertët dhe sekretariatin teknik nga Drejtoria e Barazisë Gjinore;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Institucionet e teknologjisë dhe medias	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Takim konsultues me ekspertët dhe sekretariatin teknik nga Drejtoria e Barazisë Gjinore;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Përfaqësues të sistemit të drejtësisë	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Takim konsultues me ekspertët dhe sekretariatin teknik nga Drejtoria e Barazisë Gjinore;</i>	<i>Ftesë me email,</i>
Përfaqësues të institucioneve	<i>Konsultim për Projektligjin</i>	<i>Kërkesë për mendim me shkrim;</i>	<i>Kërkesë për mendim me</i>

publike në nivel qendror (Ministri dhe institucione varësie)			shkrim dërguar me postë;
--	--	--	--------------------------

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

Lista e të gjitha aktiviteteve të parashikuara të konsultimit me datën e përafërt të zbatimit.

Konsultimi i parë me grupin Teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve të projektligjit për prandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje u mbajt më 4 shtator 2025, ndërsa takimi I gjashtë dhe I fundit u mbajt më date 10 shtator 2025.

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike më date 06 tetor 2025 deri më date 3 nëntor 2025.

4. Burimet e nevojshme

Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.

Sekretariati Teknik për projektligjin për 'Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje', përbëhet nga stafi i Drejtorisë së Barazisë Gjinore, Sektori i Luftës Ndaj Dhunës në Familje.

Personat përgjegjës për mbledhjen e komenteve dhe përgjigjeve.

Znj. Sara Zaimi, Përgjegjës Sektori, Sektori i Luftës Ndaj Dhunës në Familje;

Z. Xhenson Cela, Specialist Sektori i Barazisë Gjinore.

5. Mbledhja e përgjigjeve

Përshkruani mënyrën se si mendoni që të mblidhni përgjigjet.

- *Komente dhe rekomandime nga grupet e interesit, pjesëmarrëse në takimet konsultuese të cilat do të mbahen shënim, do të këtë follow up dhe do të reflektohen në projektligj;*
- *Përgjigjet do të mblidhen nga mendimet me shkrim të dërguara nga 33 institucione në nivel qendror për tu konsultuar me projektligjin 'Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje';*
- *Komentet do të mblidhen nga Regjistri i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike.*

6. Monitorimi i procesit

Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiore dhe metodave/mjeteve që do të përdorni për matjen e suksesit gjatë dhe në përfundim të procesit.

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit				
Korniza e procesit		Përshatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni, si do të përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)	
A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar?		☐ po ☐ jo	Aktivitetet u realizuan sipas afateve të caktuara. Procesi i pjesëmarrjes mund të përmirësohet me pjesëmarrjen e grupeve fetare të interesit. Megjithatë, projektligji ka qenë publik në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike.	
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara?		☐ po ☐ jo		
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?		☐ po ☐ jo	Procesi do të përmirësohej më tej me rritjen e numrit të burimeve njerëzore.	
Treguesit sasiore				
Treguesit sasiore (deklaroni treguesit për monitorim)	Vlerat e planifikuara (deklaroni treguesit për vlerat)	Vlerat e arritura (deklaroni vlerën e arritur)	Përshatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
(plotësojeni gjatë fazes së planifikimit të procesit)		(plotësojeni gjatë monitorimit)		
numri i metodave të konsultimit	4 (takime konsultuese, e-konsultime, konsultime publike dhe mendime me shkrim)	4	☐ po ☐ jo	
numri i palëve të përfshira	33 institucione (Ministri, inst. Varësie) 61 Koordinatorë Vendorë kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. 24 Organizata të shoqërisë civile;	6 grupe palësh të përfshira në proces.	☐ po ☐ jo	

	12 institucione të pavarura; 7 institucione të shoqërive të informacionit; 2 institucione të sistemit të drejtësisë.			
☐ numri i pjesëmarrësve	153	153 në total nga të gjitha palët e përfshira.	☐ po ☐ jo	
numri i komenteve të pranuara	Numri i komenteve është rreth 180, të parashtruara nga të gjitha institucionet dhe organizatat pjesëmarrëse gjatë procesit të konsultimit publik për projektligjin.	Komentet janë ende në proces reflektimi.	☐ po ☐ jo	
☐ tjetër:			☐ po ☐ jo	
Mjetet për matjen e treguesve				
☐ lista e pjesëmarrësve ☐ raportimi i aktivitetit ☐ raporti i reagimeve ☐ lista e komenteve të marra ☐ tjetër:				
Treguesit cilësorë				
Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)	Gjetjet (deklaroni gjetjet)	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)		
cilësia e metodave të konsultimit	Procesi i konsultimit për projektligjin “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” mund të konsiderohet i gjerë, gjithëpërfshirës dhe me cilësi të mirë, si në aspektin metodologjik ashtu edhe në rezultatet e prodhuara.			

	Metodat e konsultimit kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe efektive, duke gjeneruar një sasi të konsiderueshme komentesh cilësore. Përdorimi i kombinimit të takimeve, konsultimeve online dhe kërkesave me shkrim tregon një proces të mirëstrukturuar, të hapur dhe tërësisht në përputhje me standardet e pjesëmarrjes publike në proceset ligjvënëse.	
përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve	N/A	
cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara	Në përgjithësi, komentet janë të nivelit të mirë profesional dhe teknik, që tregojnë përfshirje reale dhe ekspertizë të aktorëve në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna. Ato përbëjnë kontribut të vlefshëm për përmirësimin e projektligjit, sidomos në: përputhjen me legjislacionin ekzistues, zgjerimin e kuptimit të dhunës me bazë gjinore, forcimin e rolit të institucioneve vendore. Megjithatë, ka disa mangësi: disa komente janë përsëritje të njëra-tjetrës midis organizatave; mungojnë shpesh vlerësime buxhetore dhe të kapaciteteve për zbatim; mungon në disa raste koordinimi i qëndrimeve midis institucioneve publike dhe OJF-ve.	
☐ treguesit sipas objektivave të procesit:	Numri dhe larmishmëria e pjesëmarrësve nga të gjitha institucionet e linjës dhe grupet e interesit; Lloji dhe forma e konsultimeve (publike, online, me shkrim në rrjetet sociale);	

	Cilësia e komenteve dhe fusha teknike dhe tematike që targetojnë.	
Mjetet për matjen e treguesve		
☐ pyetësi i vlerësimit ☐ diskutimi joformal me pjesëmarrësit ☐ regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve ☐ raportimi i aktivitetit ☐ tjetër:		